



VËSHTRIM MBI
POLITIKAT RINORE
NË SHQIPERI

*Analizë në nivel qendror dhe lokal 2015-
2019*

Autorë:

Dafina Peci

Xhulio Nikolli

Vështrim mbi politikat rinore në Shqipëri

Analizë në nivel qendror dhe lokal 2015-2019

Nga seritë e Rezolutës së Rinisë

Studim/Raport/3/2017

Autorë

Dafina Peci

Xhulio Nikolli

2017

Përgatitur nga: Kongresi Rinor Kombëtar

Kongresi Rinor Kombëtar

Address: Rr. Milto Tutulani, Nd. 6, Hyrja 8/ 3 & 4, 1019,

Tirane - Shqipëri

kongresrinor@gmail.com

Kjo punë kërkimore është mbështetur nga



Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung

Gjetjet, opinionet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	5
Metodologjia.....	7
Fotografim i situates	8
I. Edukimi.....	10
Vizioni dhe planifikimi në makro	10
Analiza Ekonomike, Sociale e Politike në nivel lokal	10
Përfundime dhe rekomandime	14
II. Punësimi.....	16
Vizioni dhe planifikimi në makro	16
Analiza Ekonomike, Sociale e Politike në nivel lokal	18
Përfundime dhe rekomandime	21
III. Hapësirat Publike	23
Vizioni dhe planifikimi në makro	23
Analiza Ekonomike, Sociale e Politike në nivel lokal	23
Përfundime dhe rekomandime	26
IV. Siguria Sociale	27
Vizioni dhe planifikimi në makro	27
Analiza Ekonomike, Sociale e Politike në nivel lokal	28
Përfundime dhe rekomandime.....	30
V. Integrimi në BE.....	31
Mundësi për asistencë dhe potencial, makro	31
Instrumenti për Asitencën e Para-Aderimit (IPA)	31
Instrumenti i BE-së për Integrimin (EU Integration Facility)	33

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Përfundime dhe rekomandime	35
ANEKS 1	37
Rasti i Kosovës në menaxhimin e politikave rinore në nivel lokal dhe qendror	37
Parimet mbi të cilat mbështeten strategjia dhe plani i veprimit për rininë	37

Lista e Tabelave

Tabela 1. Niveli i shpenzimeve në arsim për vitin 2017 sipas njesive të qeverisjes vendore. (000/lekë)	13
Tabela 2. Fonde të parashikuara nga Agjensia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve 2017-2019.....	21

Lista e Figurave

Figura 1. Niveli i investimeve të planifikuara në PBA 2017-2019 në sektorin e Arsimin (në mijë lekë)	11
Figura 2. Niveli i shpenzimeve në milionë lekë për çeshtjet ekonomike dhe tregut të punës sipas njesive të qeverisjes vendore për 3- mujorin e dytë 2017.....	19
Figura 3. Fondi për ndertimet e reja për zhvillimin e sportit nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve 201-2019 (në mijë lekë).....	24
Figura 4. Fondet për ngritjen e qendrave të reja rinore dhe pajisjeve për funksionimin e tyre për vitin 2017-2020 (në mijë lekë).....	25
Figura 5. Shpenzimet për Programin e Mbrojtjes Sociale nga njesitë e qeverisjes vendore për vitin 2017-2019 (në mijë lekë).....	29
Figura 6. Investimet nga Programet dhe donatorë të BE në Shqipëri spër vitet 2015- 2019 (në mijë lekë)	34

Hyrje

Kongresi Rinor Kombëtar në bashkëpunim me të gjitha organizatat e rrjetit, por edhe me gjere me në fokus rininë, si dhe me forumet rinore të partive politike në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, 12 Gusht 2016 pas një punë të përbashkët disa mujore nënshkruan zyrtarisht Rezolutën e Rinisë. Rezoluta është një dokument politik që për herë të parë identifikon dhe vendos interesat e të rinjve shqiptar përpara interesave partiakë apo fokuseve të subjekteve të ndryshme. Në kuadrin e iniciativës së Rezolutës së Rinisë është punuar për të forcuar dhe dhënë shtysë frymës së bashkëpunimit ndërmjet të rinjve përtej bindjeve apo kahut politik, angazhimet të tyre profesional apo karakteristikave të tjera që paraqesin ndasi në 12 qarqet e Shqipërisë.

Në fazën e parë të kësaj iniciative mbi 400 të rinj pavarësisht mënyrës së përfshirjes në politikë (forume politike apo shoqëri civile), bindjeve politike kanë diskutuar mbi problematikat dhe zgjidhjet potenciale mbi tema si: Edukimi, Punësimi i të rinjve, Hapësirat Publike, Siguria Sociale, Çështjet e Integritimit në BE. Diskutimet mbi sistemin arsimor kanë zënë një pjesë të madhe të diskutimeve, duke e sjellë çështjen të rëndësishme dhe komplekse por nga përfundimet pavarësisht pikëpamjeve politike del si nevojë një inovacion dhe kreativitet në sistemin tonë arsimor, përshtatja e profileve të studimit profesional sipas nevojave të tregut të punës në nivel lokal si dhe një përmirësim i infrastrukturës arsimore. Papunësia tek të rinjtë është një temë që në secilin qytet ka patur një vëmendje dhe theksi është vendosur tek roli i shtetit, institucioneve qendrore apo vendore, për hartimin e politikave dhe iniciativave për mbështetjen e sipërmarrjes rinore. Gjithashtu një element i rëndësishëm dhe i domosdoshëm është studimi i tregut të punës shoqëruar me një strukturë të mirëfilltë këshillim karrierë në secilin cikël arsimor që vazhdon të jetë një mungesë e cila krijon konfuzion dhe pasoja në rrugën profesionale të të rinjve. Procesi i integritimit për vendin tonë ka qenë dhe është një proces i gjatë por që nga ana tjetër ka nevojë për një informim më të gjerë të popullsisë e konkretisht të të rinjve. Kjo ka qenë një problematikë që është evidentuar në çdo qark si edhe nga ana tjetër një gatishmëri e të rinjve për të qenë pjesë e procesit aty ku kontributi i tyre është i nevojshëm. Siguria Sociale vjen si një ndër temat më komplekse që është diskutuar në secilin nga qarqet por që pika e përbashkët ka qenë institucionalizimi dhe forcimi i rolit të shërbimit të kujdesit social si edhe një vëmendje më e lartë kundrejt sigurisë në rrjetet sociale. E së fundmi, Hapësirat Publike është një temë që ka patur të njëjtën problematikë edhe kërkesë në secilin zonë, ku nga njëra anë qëndron mungesa

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

e tyre përballë kërkesës për shtimin apo rivitalizimin e atyre ekzistuese. (Lidhje me qëndrorin)

Në vitin 2007 kemi hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë (2007-2013), përmes së cilës synohej hartimi i strategjive dhe politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve me të cilat përballen të rinjtë. Në vitin 2014 u ndërmorën konsultat e para nga ana e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me përfaqësues të shoqërisë civile, respektivisht drejtues të organizatave rinore dhe aktivistë të cilët sollën inputin e tyre dhe përzgjedhën tematikat bazë për ndërtimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë, i cili shënoi një moment të rëndësishëm kthese në mënyrën sesi politika po i përqaset këtij target grupi dhe anasjelltas.

Zotimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë për periudhën 2015-2020 konsistonte në ndërtimin e një dokumenti themelor për bashkërendimin dhe zbatimin e politikave ndërsektoriale për rininë duke filluar nga punësimi dhe arsimi, mbrojtja e shëndetit dhe mbrojtja sociale, kultura, sporti dhe vullnetarizmi, e veçanërisht rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset demokratike dhe vendimmarrjen politike. Objektivat kryesore të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë janë gjashtë. Nxitja dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendim-marrjet demokratike, përbën objektivin e parë strategjik dhe kishte si qëllim jo vetëm krijimin e infrastrukturës përkatëse për mbështetjen e të rinjve, qendrave rinore, por dhe forcimin e strukturave dhe kapaciteteve të organizatave dhe grupeve rinore. Nxitja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës, përmirësimit të kuadrit ligjor, mbështetjes së programeve “start-up” zgjerimit të kurseve të ofruara nga shkollat e Aftësimin Profesional dhe krijimit të konkurseve që nxisin idetë inovative. Shëndeti, Sporti dhe Mjedisi, kanë si objektiv strategjik ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit të të rinjve përmes politikave të integruara shëndetësore, shoqëruar me masivizim të kulturës sportive. Edukimi i të Rinjve, ky objektiv synonte përmirësimin e kurrikulave të lidhura me aftësimin për jetën, përmirësimin dhe forcimin e zinxhirit të sistemit arsimor. Mbrojtja Sociale, aktivitetet e parashikuara në këtë plan synojnë forcimin e hallkave të këtij sistemi duke filluar që nga forcimi i kapaciteteve dhe deri tek ndërveprimet komunitare. Kultura dhe vullnetarizmi, qëllimi i këtij objekti konsiston në përmirësimin e mundësive për të rinjtë për organizimin e kohës së lirë në aktivitete dhe veprimtari të fushave të ndryshme.

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Përvoja disa vjeçare e Kongresit Rinor Kombëtar e bazuar në aktivizimin tonë në dymbëdhjetë qarqe të Shqipërisë, duke e prekur nga afër situatën në terren dhe duke bashkëpunuar me aktorët lokal na dha indicien e të pasurit të një vizioni mbi çështjet zhvillimore më me rëndësi për rininë e këtij vendi, por edhe një panormaë fort të qartë të situatës reale së paku në këto tre vitet e fundit. Përceptimet e rinisë mbi politikëbërjen, dëshmitë mbi progresin e shumëkërkuar dhe hendeku që qëndron midis idealeve të planifikuara dhe situatës në terren na e kanë bërë edhe më të qartë vizionin e punës tonë. Ky vizion shëmbëllen progresin dhe zgjidhjen e ngërceve politike, ekonomike e sociale, mirëpo për të mbërritur në atë pikë së pari duhet një fotografim real i situatës dhe së dyti identifikimi me baza të shkaqeve që sjellin problematikat e çështjeve në fjalë. Në vazhden e Rezolutës së Rinisë, si dokument por edhe si iniciativë, ky studim vjen si i pari vështrim në llojin e tij, i dokumentuar dhe i bazuar, me synimin për të sjellur në një shteg përvojën qëndrore dhe lokale të trajtimit të politikave rinore nga ngjizja deri në zbatimin e tyre.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për të vlerësuar iniciativat e ndërmarra në nivel lokal si në aspektin institucional ashtu edhe në atë joformal, u bazua në kërkim dokumentar dhe në intervistat, kontaktet e drejtpërdrejta në terren në 12 qarqet ku Kongresi Rinor praktikisht operon. (cilësim)

Vlerësimi dokumentar apo ndryshe i bazuar në burime dytësore përfshin bazën ligjore, strategjinë dhe planin kombëtar të veprimit, planet lokale të veprimit dhe projekt buxhetet e nivelit lokal. Pjesa tjetër e informacionit bazë është siguruar nga organizatat joqeveritare me në fokus rininë, aktive dhe operationale në zonat e mbuluara në studim, si dhe mbi format model të funksionimit janë marrë në dy raste të rrjeteve kombëtare simotra në dy vende fqinje të rajonit, Kosova dhe Serbia.

Vrojtimi në terren, u përgadit në bashkëpunim me kolegë të Kongresit Rinor Kombëtar, të cilët e sjellin ekspertizën e tyre nga puna e përditshme e fokusuar në çështjet e rinisë, duke na vënë në dispozicion strategjitë e organizatave respektive, eksperiencën e bashkëpunimit me institucionet lokale dhe këshillat lokal, si dhe me institucione të tjera arsimore apo të kujdesit social. Gjithashtu një sërë intervistash dhe bisedash janë kryer me drejtues të organizatave dhe drejtorive relevante që mbulojnë politikën rinore në institucionet lokale më synim mbledhjen e informacionit e po ashtu përceptimin dhe konceptimin e situatës sipas vëndit.

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Theksojmë që opinionet e mbledhura gjatë këtij studimi shërbejnë vetëm për ilustrim dhe nuk pretendojnë të japin një përfaqësim statistikor shkencor të rinisë në zonat e ndërmarra në fokus. Këto të dhëna shënojnë një përpjeke të parë për të ofruar një panoramë të qartë të trajtimit të këtij target grupi nga ana e politikëbërësve dhe vendimarrësve lokal, donatorëve dhe prezencës ndërkombatëre në nivel lokal, si dhe hendekut që ekziston ndërmjet planifikimeve makro dhe zbatimit në terren. Keto informacione na orientojnë mbi gjëndjen aktuale të rinisë shqiptare, fokusuar në pesë tematikat kyçe të ndërmarra në trajtesë: Edukimi, Punësimi i të rinjve, Hapësirat Publike, Siguria Sociale dhe Integrimi në BE. Panorama synon të përçojë atë që është bërë dhe jo, në tre vitet e fundit lidhur me rininë, sa të planifikuara dhe të buxhetuara janë këto çështje, si dhe identifikimin e hallkave të dobëta ndërmjet qëndrorit dhe lokalit në aspektin e zbatimit të ligjit apo politikave të caktuara. Ky informacion u shërben politikëbërësve në nivel qëndror, lokal si dhe aktorve të ndryshëm aktiv me të rinjtë, vëndas dhe të huaj.

Fotografim i situates

Rinia, si pjesa më e madhe e shoqërisë shqiptare vuan shkallën më të lartë të papunësisë nga të gjithë grupmoshat. Sipas të dhënave të INSTAT dhe raporteve më të fundit të botuara lidhur me papunësinë e të rinjve kjo çështje mban vëndin prima si një nga problemet më madhore në shoqërinë shqiptare dhe pashmangshmërisht e lidhur me pikën pararendëse të saj , që është edukimi i ndarë në dy aspekte, sistemi arsimor formal dhe metodat e edukimit joformal. Megjithë përpjekjet e viteve të fundit si nga qeveria ashtu edhe nga fundacione të huaja të profilizuara në promovimin e arsimit profesional për të shtuar nivelin e informimit mbi rëndësinë e këtij të fundit dhe mundësitë reale për punësim, të rinjtë vazhdojnë të tërhiqen nga ideja e studimeve universitare. Karakteristikë e sistemit të edukimit në përgjithësi mbetet përfshirja e ulët e të rinjve në praktika/stazhe gjatë studimeve edhe pse vlerësohet si një ndër mekanizmat kryesorë për kalimin nga shkolla në punë. Vetëm një pjesë e vogël krahasuar me të tërën shprehen të kenë kryer praktika dhe specifikisht praktika të kryera me seriozitet dhe të planifikuara si pjesë e kurrikulës të institucionit arsimor ku aderojnë. Përsa i përket angazhimit social vërehet se vetëm ¼ e të rinjve janë përfshirë në aktivitete vullnetare me bazë kontributin dhe sensibilizimin në komunitet. Mungesa e theksuar e hapësirave publike si në formën e qendrave multifunksionale ashtu edhe në atë të

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

këndeve sportive me mundësi angazhimin fizik dhe rekreacionin kanë shkaktuar një handikap të theksuar në fasilitimin e kushteve të të rinjve për një jetesë më të shëndetshme dhe mundësi për edukim jorformal. Lidhur me sigurinë sociale mund të përmendet fakti i neglizhimit të këtij dimensionit në çdo aspekt duke e konsideruar rininë si një target specifik me nevoja specifike. Sfidat në këtë sektor lidhen me fuqizimin ekonomik të të rinjve përmes programeve nxitëse të punësimit, arsimimit, shëndetit dhe mbrojtjes sociale; krijimin e hapësirave publike në shërbim të të rinjve; forcimin e kapaciteteve të organizatave rinore dhe krijimin e rrjeteve rinore, krijimin e këshillave rajonale dhe komiteteve kombëtare këshillues për çështje që lidhen me të rinjtë; rritjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në programe komunitare dhe ndër-rajonale. Në këtë kuadër është punuar praktikisht që nga viti 2007-2013 nëpërmjet Strategjisë së Rinisë dhe më pas 2014 dhe përgaditja për 2015-2020 nëpërmjet Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë, i cili synoi të përfshijë grupet e interesit në procesin e konsultimit, duke pasur në thelb domosdoshmërinë për ndërtimin e platformave të qarta për të rinjtë për të krijuar hapësira në kultivimin e potencialit dhe kreativitetit të tyre.

I. Edukimi

Vizioni dhe planifikimi në makro

Investimi më i sigurtë i cdo kombi apo qeverie është investimi në arsim, edukimin e brezit të ri. Referuar Planit Kombëtar të Rinisë¹, parësore në lidhje me çështjen e edukimit qëndron përmirësimi i kurrikulave të lidhura me aftësimin për jetën, të cilat janë element kryesor në edukimin e brezit të ri dhe zvogëlimi i përfshirjes në sjellje antisociale. Në të njëjtën kohë ky plan parashikohen një sërë masash që lidhen me përmirësimin dhe forcimin e zinxhirit të sistemit arsimor, duke filluar që nga ulja e numrit të nxënësve për klasë, përmirësimi i bazës teknike/laboratorike në shkolla, edukimi në vazhdim dhe i akredituar të mësuesve dhe deri tek krijimi agjencive të pavarura me ekspertë të jashtëm për monitorimin dhe vlerësimin e sistemit arsimor dhe procesit mësimor në veçanti. Fuqizimi i qendrave të ekselencës dhe njësisive kërkimore shkencore janë dy nga çështjet e rëndësishme të ngritura në planifikimet kombëtare lidhur me politikën e edukimit. Një tjetër aspekt që ka për qëllim forcimin e edukimit të rinjve është dhe krijimi i marrëveshjeve të përbashkëta me universitete të ndryshme të EU dhe më tej, me qëllim rritjen e shkëmbimit akademik dhe krijimin e rrjetit të “mentorimit” mes akademikëve dhe studentëve të përfshirë në aktivitete shkencore dhe akademike.

Analiza Ekonomike, Sociale e Politike në nivel lokal


Shqipëria ka një numër prej 596 624 studentësh në tre ciklet e arsimit të regjistruar, në arsimin 9- vjeçar, të mesëm dhe atë terciar. Në secilin program qeveritar lokal apo qendror mbështja e arsimit dhe shpenzimet për arsimin përbejnë prioritet edhe pse mbështja në buxhet për arsimin nuk kalon shifren e 4 % ndaj totalit të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto. Shpenzimet për arsim është e ndarë në dy pjesë në shpenzimet për arsimin në nivel lokal dhe atë qendror. Problematikat e sektorit të arsimit është e ndarë në pjesën e cilësisë dhe infrastrukturës arsimore. Specifikat lokale ndryshojnë nga njeri qytet në tjetrin persa i perket arsimit dytësor ndersa në arsimin parësor situatë është pothuajse e njëjtë.

¹ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 miratuar me VKM nr. 383, datë 6 maj 2015.

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Investimet në fushën e arsimit ndahen në ato qendrore të cilat janë në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe në investimet lokale të cilat janë pjesë e buxheteve të njesive të qeverive vendore. Në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2017 – 2019 mbeshjtjetja e arsimit është nëpërmjet ndarjes së investimeve nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në mbeshjtjetën e arsimit profesional dhe nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në investimet në arsimin bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe atë të lartë. Në figurën 1 është e pasqyruar mbeshjtjetja me fonde për investimet për arsim sipas cikleve të arsimit.

Figura 1. Niveli i investimeve të planifikuara në PBA 2017-2019 në sektorin e Arsimin (në mijë lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2017)

Niveli i investimeve në fushën e arsimit ndryshon nga njeri cikël në tjetrin ku peshën më të madhe e mbajnë investimet në Arsimin e Mesëm, respektivisht 4.3 mld lekë për Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm dhe 2.487 mld lekë në Arsimin e Mesëm Profesional. Fondet për Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm janë të ndara në dy elementë:

- 2.106 mld lekë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për ndertimet e reja të shkollave të mesme në institucionet e qeverisjes vendore.
- 2.194 mld lekë projekte ristrukturimi dhe ndertimi shkollave të mesme dhe terrenet sportive pranë tyre në qytete të ndryshme të Shqipërisë(Berat, Lezhë, Tiranë, Fier, Vlorë, Lushnje, Dibër)

Ministria e Arsimit dhe Sportit sipas strukturës së qeverisë që është hartuar PBA 2017-2019 në planifikimet për investime në arsimin bazë përsëri është e ndarë në dy elementë ku :

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

- 3.321 mld lekë janë fonde për projektet në zhvillim për vitin 2017 dhe për ato të prapambetura të cilat janë të destinuara për ristrukturim dhe ndertim godinash të arsimit bazë. Investimet për Arsimin Bazë janë të shperndara në 46 godina të arsimit bazë në qytete si :Shkodër, Fier, Lushnje, Vlorë, Berat,Sarandë, Pukë,Durrës,Korcë, Bulqizë etj.
- 1.075 mld lekë janë fonde të cilat do të jenë në dispozicion të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për investime të reja për vitin 2018-2019.

Në strukturën e mëparshme arsimit mesëm profesional ka qënë në varësinë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ndersa në strukturën e re të qeverisë investimet në arsimin profesional do të jenë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Sipas planifikimeve në PBA 2017-2019 në arsimin e mesëm profesional janë parashikuar investime me vlerë 2.487 mld lekë, fonde këto të parashikuara në ndertime dhe ristrukturime të ambientëve të shkollave të mesme profesionale. Disa nga investimet në Arsimin e Mesëm Profesional sipas qyteteve ku ndodhen janë : Ndertim i ri dhe rikostruksion i shkolles dhe bazes prodhuese Shkolla “Hoteleri, Turizem”, Tirane ; Rikonstruksion shkolla “Hamdi Bushati “, Shkodër ; Ndertim i ri baza prodhuese, dhe rikostruksion shkollës “Arben Broci”, Shkoder; Ndertim i ri dhe rikostruksion, baza prodhuese dhe shkolles “Pavarsia”, Vlore; Rikonstruksion dhe ndertimi shkolla dhe baza prodhuese “Ali Myftiu”, Elbasan; Rikonstruksion shtese kati per baze prodhuese për shkollën “Kristo Isak” Berat ; Rikonstruksion Shkolla Tregetare Vlore; Ndertim i ri baza prodhuese per shkollen Profesionale Kamez. Projektet dhe investimet për institucionet e arsimit profesional janë të shperndare sipas viteve 2017 , 2018 dhe 2019 por që në vitin 2018 edhe 2019 fondet do të jenë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe jo në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Investimet në fushën e arsimit pervec qeverisë qendrore mund të jenë edhe me fondet e njesive të qeverisë vendore. Në njesitë e qeverisjes vendore të marrë në analizë shpenzimet për arsim në peshën më të madhe madje në disa qytete në peshë prej 100 % janë shpenzime korrente, pra shpenzime për paga, sherbime nga të tretet. Shpenzimet në arsimin bazë edhe atë të mesëm në nivel loka janë të ndara në shpenzime korrente dhe ato kapitale. Shpenzimet korrente zënë peshën më të madhe të shpenzimeve totale për arsim dhe burimi i tyre vjen nga transferta e kushtezuar e cila transferohet nga qeveria qendrore. Në PBA 2017-2019 që njesitë e qeverisjes vendore kanë planifikuar shikohet se buxheti për arsim nga njeri vit në tjetrin nuk ka luhatje në vlera të medha në perjashtim të qytetit të Kukësit dhe Fierit ku janë parashikuar

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

në vitin 2018 investime kapitale me 2.8 mld lekë në qytetin e Kukësit dhe në vitin 2019 investime kapitale me vlerë 1.2 mld lekë.

Tabela 1. Niveli i shpenzimeve në arsim për vitin 2017 sipas njesive të qeverisjes vendore.
(000/lekë)

BASHKIA	Shpenzime totale në arsim	Shpenzime kapitale në arsim
Berat	173,570	0
Dibër	66,114	681.86
Durrës	608,507	217,460
Elbasan	431,222	11,054.11
Fier	325,338	57,989
Gjirokastrë	137,533	0
Korçë	327,074	32,180.36
Kukës	152,839	0
Lezhë	248,143	21,085.28
Shkodër	357,231	22,663.18
Tiranë	2,353,674	1,109,857
Vlorë	624,165	101,845.78

Burimi : Përpunim i autorit

PBA 2017-2019 Njesitë e Qeverisjes Vendore

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Sic shikohet nga tabela 1 shpenzimet e qeverisjes lokale në arsim janë të destinuar për shpenzimet korrente, shpenzime mirëmbajtje, paga, administrimi dhe jo për investime. Investimet në njesitë e qeverisjes vendore të marrë në analizë në vlerë të lartë janë në Bashkinë Tiranë dhe Vlorë, ku Bashkia Tiranë ka realizuar investime me vlerë rreth 11 mld lekë me burimet e veta të të ardhurave ndersa pjesën tjetër me projekte nga Fondi i Zhvillimit të Rajonit ndersa Bashkia Vlorë të gjithë vlerën e investimeve e ka realizuar nga projektet e miratuara nga FZHR. Në Bashkinë Tiranë investimet janë të përqendruar në ndertimin e shkollave të reja për uljen e dendësisë nëpër klasa dhe investime në arsimin parashkollor ndersa në Bashkinë Vlorë në ristrukturimin e shkollave ekzistuese. Gjithashtu investime në fushën e arsimit për përmirësimin e infrastrukturës ka patur edhe në Bashkinë Elbasan në vlerën 110 milionë lekë dhe në Bashkinë Fier në vlerën 2.17 mld lekë, ku peshën me të madhe e kanë patur nga projektet e miratuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajonit. Gjithashtu investime në arsim ka patur dhe në Bashkinë Lezhë në vlerë 210 milionë lekë dhe me një vlerë të përafërt në Bashkinë Shkodër. Ajo çfarë vlenë të theksohet është se në perjashtim të bashkive Tiranë, Fier, Elbasan, Vlorë, Lezhë , Korçë, Durrës qytetet e tjera nuk kanë përfituar nga fondet e zhvillimit të rajoneve. Gjithashtu duke qënë se nevojat dhe problematikat janë më te prekshme nga njesitë e qeverisjes vendore duhet të rritet pesha e trasfertave të pakushtëzuara për bashkitë në menyrë që ato të rrisin shpenzimet kapitale për përmirësimin e infrastrukturës në arsim.

Përfundime dhe rekomandime

Investimet më të mëdha në fushën e arsimit konsistojnë në infrastrukturë, pra në aspektin bazik të sigurimit të një arsimimi cilësor dhe efikas. Nga vëzhgimi dhe diskutimet në 12 qaraqe vlen të përmendet se një ndër pikat kyçe dhe të pambuluara qëndron aspekti i këshillimit të karrierës, si nëpërmjet mungesës së rishikim të lëndëve të lidhura me aftësimin për jetën, dhe përshtatja e tyre sipas standarteve të BE-së dhe nevojave/kërkesave në nivel vendi. Ky objektivi qëndron në planin kombëtar të veprimit për rininë e ashtu edhe në strategjinë kombëtare që i ka paraprirë këtij plani, por ende i pa elaboruar dhe si për rrjedhojë i pazgjidhur. Kjo problematikë që të marrë zgjidhje duhet të kalojë në dy faza, së pari në vlerësimin mbi cilësinë e infomacionit në lëndët e aftësimin për jetën dhe hartimin e rekomandimeve përkatëse, si dhe përmirësimi i kurrikulës apo i metodave të tjera joformale të përshtatura sipas nevojave dhe standarteve bashkohore. Gjithashtu duhet përmendur niveli i ulët i informimit në gjimnaze dhe univesitete për mundësitë ekszistente mbi aplikimet në

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

programet e Bashkimit Evropian Erasmus +, por edhe të programeve të tjera të karakterit rajonal RYCO, ËB Fund etj. Integrimi i metodave ‘peer to peer education’ dhe trajnimet mbi këto programe duhet të jenë pjesë e strategjisë së informimit dhe kjo strategji duhet të impletohet në të 12 qarqet e Shqipërisë. Këto programe kanë një hapësirë të vecanta edhe për një tjetër objektivi të përealizuar të planit kombëtar të veprimit që është mbështetja e kërkuesve të rinj shkencor. Ky objektivi kërkon së pari identifikimin e më pas ngritjen e kapaciteteve dhe angazhimit konkret të këtyre hulumtuesve në projekte të iniciuara apo fasilituara si nga ana shtetërore ashtu edhe nga stakeholder/s të tjerë relevant që e kanë pjesë të fokusit të tyre. Lidhur me arsimin profesional është I dukshëm kursi që ka marrë si në diskursin e krijuar nga qeveria dhe biznesi, por edhe në perceptimet e shoqërisë. Mirëpo ende ka një mungesë të një studimi të mirëfilltë të tregit të punës dhe një orientim të kurrikulave dhe profileve të shkollave të mesme profesionale në përputhje me specifikat e sektorëve ekonomik dhe potencialit zhvillimor në nivel lokal.² Së fundmi, edukimi joformal si një ndër temat më të lëvruara dhe të parapëlqyera nga trendi I kohës, kërkron fonde dhe koordinim më qëndrat, organizata ekzistuese apo individë me ekspertizë dhe kapacitete dhe t’i jepet rëndësia dhe kushtet duhura (duke implikuar këtu edhe hapësirat publike) në mënyrë që ky lloj edukimi të ofrohet sidomos atyre grupeve sociale të cilat e kanë më të vështirë aksesimin e institucioneve klasike të arsimit

² Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri 2000-2012, Ëorld Bank Group, Qershor 2014

II. Punësimi

Vizioni dhe planifikimi në makro

Vendet në zhvillim dhe në një tranzicion të gjatë sic ndodhet Shqipëria përballet me probleme të medha persa i perket tregut të punës. Gjatë viteve të fundit rritja ekonomike dhe nivelet e punësimit nuk kanë patur një vijë të njëtrajtshme lineare, por kanë pësuar në mënyrë të vazhdueshme ulje dhe ngritje. Edhe pse kuadri ligjor për mbrojtjen e investimeve është përmirësuar dhe ka patur mbështetje për bizneset e reja, përsëri punësimi mbetet problem për shoqërinë shqiptare. Nga kjo situatë, të rinjtë, edhe pse janë pjesa më produktive dhe aktive e popullsisë, vuajnë pasojat e papunësisë dhe mbi të gjitha mungesën e politikave që mbështesin fuqizimin dhe hapjen e bizneseve rinore dhe rrjedhimisht rrisin numrin e të rinjve të punësuar. Nga analiza e objektivave dhe rezultateve të dokumentave strategjikë që kanë qënë në fuqi në periudhën 2005-2013 / 2015 mund të vihet re që, ndonëse përmirësimi i situatës së punësimit të të rinjve ka qënë një objektiv i përhershëm, zbatimi i këtyre dokumentave ka qënë problematik, sidomos për shkak të mungesës së një qasjeje rajonale/lokale nga konceptimi e deri në zbatim.

Ajo që vihet re nga këto dokumenta është se ka një ndërlidhje të fushave të kompetencës midis disa institucioneve lidhur me punësimin dhe politikën e punësimit, arsimin dhe formimin profesional, rininë, zhvillimin ekonomik, dhe politikën fiskale. Kjo mbivendosje ka qënë karakteristikë edhe e dokumentave të shkuar strategjikë dhe krijon probleme për vlerësimin dhe llogaridhënien sipas fushës së kompetencës midis institucioneve publike.³ Ky fakt e bën tejet të rëndësishëm koordinimin dhe bashkëpunimin midis institucioneve publike sipas fushës së kompetencës, me qëllim koordinimin e aktiviteteve dhe realizimin e objektivave dhe rezultateve të përcaktuara sa më sipër.

Për strategjitë të cilave u ka përfunduar afati i zbatimit (2007-2013 dhe 2010-2013) nuk ka dokumente të vlerësimit. Kjo është rrjedhojë e mungesës së mekanizmave dhe mjeteve funksionale standarde, që garantojnë etapat e zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe llogaridhënies sipas standardeve të Bashkimit Evropian. Ky fenomen nuk është specifik për politikën e punësimit por karakterizon ciklin e politik-berjes shqiptare në përgjithësi. Për mbi

³ Youth Employment Trends in Albania: Ëhat is the Market Looking For?, CDI & FES Tirana, 2015, <http://cdinstitutë.eu/ëeb/ëp-contënt/uploads/2016/05/t-150427-tëxt-engl.pdf>

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

500 dokumente politike që ndodhen në Repository të Politikave Publike të Shtetiëeb⁴, janë me pak se një duzinë dokumentesh monitorimi.

Kryefjala e Planit Kombëtar të Veprimit të cili i referohemi është rritja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës, përmirësimit të kuadrit ligjor, mbështetjes së programeve “start-up” me fokus sipërmarrjet rinore, zgjerimit të kurseve të ofruara nga shkollat e Aftësisimit Profesional dhe krijimit të konkurseve që nxisin idetë inovative. Një risi që solli plani aktual të veprimit për rininë është dhe njohja e praktikave profesionale dhe internship-it dhe çertifikimi dhe njohja e diplomave dhe aftësive profesionale të fituara në vendet ku të rinjtë mund të kenë punuar apo emigruar.

Një tjetër e re në këtë plan veprimi është dhe patentimi i ideve apo mbrojtja e bizneseve dhe sipërmarrjes rinore përmes skemës mbrojtëse të patentimit (copy right). Kjo do të sillte jo vetëm nxitjen e të rinjve për të ushtruar këto profesione dhe praktika të mira pune në Shqipëri por dhe futjen e ideve novatore apo zanateve të ndryshme, në të cilat të rinjtë që jetojnë në Shqipëri mund të mos kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për ushtrimin e tyre. Krahas mbështetjes direkte të profesioneve apo bizneseve rinore, në këtë plan është parashikuar dhe forcimi i kapaciteteve menaxheriale të të rinjve dhe organizatave rinore përmes ofrimit të trajnimeve dhe shkollave verore në fushën e menaxhimit dhe liderit-it, por dhe përmes dhënies së konsulencave ligjore dhe financiare për të rinjtë që kanë apo duan të hapin një biznes dhe organizatave rinore. Fuqizimi i burimeve të informacionit është tjetër temë e shumëpërmendur, në mënyrë që të rinjtë dhe organizatat rinore do të informohen në mënyrë periodike mbi mundësitë e punësimit nga subjektet private dhe shtetërore, aktivitetet që do të organizohen për ngritjen e kapaciteteve të tyre, kurset e reja profesionale, e të tjera.

Planin po ashtu parashikon një pjesë që i kushtohet fuqizimit të bazës praktike dhe profesionale të universiteteve, e cila mund të përdoret jo vetëm për rritjen e njohurive profesionale të studentëve, por dhe si një mundësi për krijimin e mini-bizneseve, përmes të cilit prodhimet e krijuara në bazat universitare të shiten dhe rrisin të ardhurat e universiteteve.⁵

⁴ <http://shtetiëeb.org>

⁵ Raporti Progresi i Strategjise Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020, MPRShB 2016


Analiza Ekonomike, Sociale e Politike në nivel lokal

Problematika që lidhen me shkallën e lartë të papunësisë dhe nivelin e lartë të informalitetin në tregun e punës. Sipas Istitutit të Statistikave në tremujorin e dytë të vitit 2017 shkalla e papunësisë në vendin tonë është në nivelin e 14.3 % apo në nivel absolute numri i të papunësve të regjistruar është në 191 533 individë të papunë të regjistruar. Numri të rinjëve të grupmoshës 15-29 vjeçarë të papunë të regjistruar është 77 780 individë të papunë ose në vlerë relative është 40.9 % të totalit të papunëve të regjistruar në Shqipëri. Niveli i papunësi ndryshon luhatet nga njëri qark në tjetrin ku nivelin më të lartë të papunësisë e ka qarku i Vlorës me 24.7 % pasuar nga qarku i Lezhës, Tiranës dhe Fierit respektivisht me 18.3 % , 16.4 % dhe 15.5 % . Ndersa qarku me nivelin më të ulët të papunësisë është qarku i Korçës. Burimi i punësimit sipas funksionev është i ndarë në tre klasa, ku 15 % e të punësuarave janë në sektorin shtetëror, 43 % në sektorin privat shërbime dhe industri ndersa 42 % në sektorin privat bujqësor.

Ulja e numrit të papunëve është një sfidë për secilën qeveri në nivel qendror apo lokal dhe secila prej tyre e percakton punësimin si prioritet të tyre. Përmirësimi i situatës së punësimit është i varur nga faktorë direktë dhe faktorë indirektë. Në aspektin lokal mbështetja në punësimin e të rinjëve është pjesë e Programit të Kulturës, Turizimit, Rinisë dhe Sportëve në programet e tyre buxhetore. Edhe pse në relacionet shpjeguese dhe në objektivat e programeve të njesive të qeverive vendore theksohet nxitja dhe iniciativat për punësimin e të rinjëve në Buxhetin 2017 dhe PBA 2017-2019 mbështetja me fonde është në nivelin zero lekë. Fondet për Programin e Rinisë, Turizmit, Kulturës dhe Sporteve janë të shpërndara në fonde për sektorin e turizmit dhe kryesisht në vlerë të lartë në mbështetjen e aktiviteteve sportive. Në asnjërin nga bashkitë e marrë në analizë nuk ka një fond specifik për mbështetjen e punësimit të rinjëve dhe ndertimin e hapësirave të reja për punësimin e të rinjëve. Por përveç faktorëve direkt që ndikojnë në përmirësimin e punësimit të rinjëve ka edhe faktorë indirektë apo faktorë që janë në një lidhje të drejtperdrejtë. Investimet në secilin sektorë ndikojnë në rritjen e shanseve për punësimin e të rinjëve. Mbështetja e arsimit profesional si edhe investimet në sektorë prioritarë sipas burimeve lokale janë mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës ku përfitues mund të jenë edhe grupmosha 15-29 vjeçarë.

Një indikator jo i drejtpërdrejtë por që është i lidhur me punësimin është zhvillimi ekonomik i cdo njesie të qeverisjes vendore. Fondet e parashikuara për zhvillimin ekonomik përveç rritjes në terma makro të ekonomisë janë të lidhura dhe me numrin e të punësuarve. Niveli i shpenzimeve të cilat lidhen me çeshtjet ekonomike dhe punësimin për njesitë e qeverisjes vendore për 6 mujorin e parë të vitit 2017 janë të pasqyruara në grafikun numër 2 si më poshtë.

Figura 2. Niveli i shpenzimeve në milionë lekë për çeshtjet ekonomike dhe tregut të punës sipas njesive të qeverisjes vendore për 3- mujorin e dytë 2017.



Burimi : Drejtoritë e Financave Njesive e Qeverisjes Vendore (2017)

Sic shikohet nga grafiku vlerat duke e krahasuar me premtimet dhe retorikat politike janë në nivel shumë të ulët. Nivelin më të lartë e ka Bashkia Tiranë me 1.8 milionë lekë e pasuar nga Bashkia Durrës 1.52 milionë lekë ndersa bashkitë me nivelin më të ulët të shpenzimeve lidhur me çeshtjet e punësimit e kanë Bashkia Dibër me 0.59 milionë lekë për dhe Bashkia Kukës me 0.711 milionë lekë.

Punësimi në terësi dhe specifikisht punësimi i të rinjëve në nivel lokal është lidhur me politikat dhe iniciativat nga qeveria qendrore si edhe në fondet që pushteti qendror shpërndan për pushtetin vendor. Në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2017- 2019 janë parashikuar disa investime që lidhen me punësimin e të rinjëve në menyrë direkte dhe indirekte.

Në menyrë direkte mbeshtetja në punësimin e të rinjëve është nëpërmjet ligjit “Për nxitjen e punësimit” ku është e shprehur qartë hapësira dhe mbeshtetja që egziston për punësimin e të

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

rinjëve. Ku për punëkërkues të rinj, të diplomuar me arsim të lartë në nivelin “Bachelor” apo “Master”, nën moshën 30 vjeç zyrat e punësimit financojnë :

- në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për trajnimin nëpërmjet punës për çdo person, për një periudhë 3-mujore.
- për çdo punëkërkues të papunë të përfshirë në program me një pagesë pjesëmarrjeje në kurs në masën 100 përqind të pagës minimale në shkallë vendi, për të gjithë kohëzgjatjen e trajnimit. Zyra përkatëse e punësimit kryen edhe derdhjen e kontributit për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.3 përqind të pagës minimale, i cili derdhet në degën përkatëse;
- me një financim mujor në masën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore mbi pagën 25 000 (njëzet e pesë) mijë lekë për 9 muaj, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 15 muaj.
- për çdo punëkërkues të papunë të përfshirë, sipas këtij programi me katër paga në vlerën 25 000 (njëzete pesë mijë) lekë, në muajin e tretë e të katërt, dhe në muajin e tetë e të nëntë të kontratës.

Përveç iniciativave ligjore dhe akteve që lidhen me punësim në PBA 2017-2019 janë parashikuar disa investime sipas ministrive të linjës. Ku nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është parashikuar një fond prej 475 milionë lekë për Programin e Tregut të Punës, nga ky fond 292 milionë lekë janë të planifikuara për rikonstrukcionin dhe modernizimin e Qendrave të Formimit Profesional në Tiranë, Dibër, Berat si edhe blerjen e kabineteve për pjesën tjetër të QFP. Gjithashtu një fond prej 105 milionë lekë janë të parashikuara për rikonstrukcionin e DRSHKP Diber, DRSHKP Kukes, ZVP Lushnje, Gramsh, Permet, Pogradec, M.Madhe, Erseke.

Përveç fondeve nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë edhe Ministria e Ekonomisë në menyrë indirekte ka planifikuar disa fonde që mund të krijojnë mundësi punësimi për të rinjtë. Nëpërmjet Agjensisë Shqiptare së Zhvillimit të Investimeve janë parashikuara fonde për disa projekte të cilat mund të shfrytëzohen nga të rinjtë.

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Tabela 2. Fonde të parashikuara nga Agjensia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve 2017-2019

FONDI I PLANIFIKUAR	VLERA (000/LEKË)
Fondi i Inovacionit	44,874
Fondi i Konkureshmerise	171,644
Biznese te mbeshtetura me Fondfin Start-up	42,653
Mbeshtetje biznesit kreativ	45,419
Fondi në mbeshtetje të ndërmarrjeve për turizmin gjithëvjeter	34,000
Krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitetet në zonat turistike/historike.	43,000

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Mbeshtetja më zë në buxhet dhe shperndarja e fondeve për projekte start-up, mikrondërmarrjet kryesisht në sektorin e turizmit, biznesit kreativ dhe inovacionit janë një mundësi më tepër dhe që krijojnë hapësirë për gjenerimin e vendeve të reja të punës që mund të shfrytëzohen nga të rinjtë.

Përfundime dhe rekomandime

Një ndër aspektet më të rëndësishme për t'u rekomanduar lidhur me këtë temë është hartimin i planeve kombëtare për punësimin e të rinjve çdo vit⁶ me një qasje rajonale dhe lokale, duke marrë për bazë specifikat dhe nevojat e ekonomive lokale e rajonale si dhe orientimin e duhur kundrejt tregut të punës. Së dyti aspekti monitorues me baza periodike dhe vlerësimin çdo vit të dokumenteve strategjike dhe publikimin e raporteve të monitorimit / dhe vlerësimit me qëllim rritjen e transparencës së funksionimit në fushën e politikave të punësimit rinor. Këto raporte monitorimi dhe

⁶ perditësimi vjetor lehtëson harmonizimin me dokumentet e BE në këtë sektor

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

vlerësimi duhet të bëhen transparente për publikun. Gjithashtu, duhet forcuar bashkëpunimi ndërmjet institucionve arsimore, institucioneve shtetërore dhe private për ofrimin e praktikave profesionale dhe të njohura nga shteti dhe biznesi. Në linjë me rekomandimet në fushën e arsimit ky rekomandim vlen dhe për pjesën e punësimit dhe mobiliteti për të zhvilluar eksperiencën të shkëmbimit akademik, praktikave profesionale dhe punësime të përkohshme në vendet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet aplikimit në programet ERASMUS+ apo programeve të ngjashme. Në përputhje edhe me lirin kombëtar të veprimtimit qëndron ofrimi i mjediseve për zhvillimin e bizneseve rinore, me çmime simbolike/të subvencionu- ara apo duke përdorur asetet shtetërore që nuk janë në përdorim aktual. Ky objektivi duhet të vijë I përkthyer në planifikimin strategjik dhe buxhetor lokal dhe këto mjedise duhet të jenë të hapura dhe të aksesueshme edhe nga të rinjtë që vijnë nga zonat ruarë duke vënë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme.

III. Hapësirat Publike

Vizioni dhe planifikimi në makro


Hapësirat e publike për të rinjtë janë një element i rëndësishëm në mirëqenien e tyre dhe rritjen e nivelit të organizimit të të rinjëve. Të rinjtë kanë nevojë për ambjentë ku mund të mbledhen për të diskutuar, për të shprehur talentin e tyre, për tu organizuar në grupe formale apo informale si edhe për të organizuar aktivitete sipas nevojave të tyre. Gjithashtu të rinjtë kanë nevojë për ambjente rekreative për të kaluar kohën e lirë, ambjente dhe terrene sportive si edhe parqe multifunksionale. Të rinjtë në shumë qytetë të Shqipërisë e kanë të vështirë për të gjetur një ambjent për shprehur talentin e tyre, organizimin e aktiviteteve rinore apo për diskutimin e problematikave rinore. Në disa nga qytetet hapësirat publike sigurohen nga institucionet në varësi të pushtetit vendor ndersa në disa qytete mungojnë saqë dhe një pjesë të konferencave lokale janë zhvilluar në mjedise private.

Analiza Ekonomike, Sociale e Politike në nivel lokal

Hapësirat publike janë të mbështetura në buxhet nga fondet e planifikuara nga ministri të ndryshme të Qeverisë Shqiptare.⁷ Rinia edhe pse ka qënë një ze në vete në strukturën e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nuk ka patur një buxhet specifik sipas nevojave të veta. Hapësirat publike për të rinjtë janë të financuara nga planifikimet për investime nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga planifikimet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Në investimet e parashikuara në PBA 2017-2019 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për hapësirat publike janë fonde për terrene sportive të reja si edhe në rikonstruksion e terreneve sportive ekzistuese në shkollat të cikleve të ndryshme. Gjithashtu në planifikimet e MAS janë dhe fonde të destinuara për njesitë e qverisjes vendore nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për terrenet e reja sportive.

⁷ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 miratuar me VKM nr. 383, datë 6 maj 2015.

Figura 3. Fondi për ndertimet e reja për zhvillimin e sportit nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve 201-2019 (në mijë lekë)




Burimi : Ministria e Arsimit dhe Sporteve (2017)

Nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve në Programin për Zhvillimin e Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale në grantin për zhvillimin e sportit njesitë e qeverisjes lokale kanë mundësi të aplikojnë me projekte për ndertimin e terreneve sportive. Fondet për vitin 2017 kanë qënë në nivelin zero lekë ndersa për vitin 2018 këto fonde janë në vlerën e 200 milionë lekë ndersa për vitin 2019 në vlerën e 350 milionë lekë.

Qendrat Rinore janë një premtim i vazhdueshëm i politikës dhe në Planin Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 është e theksuar ngritja e tyre në secilin nga dymbëdhjetë qarqet në vendin tonë. Mbeshtetja financiare e ulët dhe mospercaktimi i kopetencave midis pushtetit qendror dhe atij lokal ka sjellë mos hapjen e tyre në nivelin e percaktuar nga Plani Kombëtar i Veprimit. Fondet e parashikuara për ngritjen e qendrave rinore të reja janë në kuadër të programit të Përfshirjes Sociale nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Sipas viteve fondet janë të shpërndara sic tregohet në grafikun 4.

Figura 4. Fondet për ngritjen e qendrave të reja rinore dhe pajisjeve për funksionimin e tyre për vitin 2017-2020 (në mijë lekë)



Burimi : Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2017)

Për vitin 2017 fondet për ngritjen e qendrave të reja rinore janë në vlerën e 20 milionë lekë dhe po aq janë fondet e parashikuara në PBA për vitin 2018 edhe vitin 2019, të ndara në 6 milionë lekë në fonde për pajisjet për qendrat rinore dhe 14 milione lekë për ndertimin e qendrave rinore. Një pesëfishim i fondeve për qendrat e reja rinore është parashikuar pas vitit 2019 në vlerën e 86 milione lekë. Por me strukturën e re të qeverisë ngritja e qendrave të reja rinore do të jetë në varësinë e Ministrinë e Shendetësi dhe Kujdesit Social.

Hapësirat publike për të rinjtë në nivel lokal janë në fokusin e dy programeve të njesive të qeverisjes vendore:

- **Programin e shërbimeve publike** ku në fokusin e tyre kanë parqet dhe mjedisët e gjelberta dhe terrenet sportive brenda lagjeve sipas njesive të qeverisjes lokale ku operojnë.
- **Programi i Arsimit, Sportit dhe Rinisë** ku në fokusin e këtij programi janë fondet për përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe hapësirat e dedikuara për të rinjtë.

Në Projekt Buxhetët Afatmesëm për dymbëdhjetë bashkitë e marra në analizë nuk ka të parashikuar fonde për hapësira publike të destinuar për të rinjtë. Investimet në Programin e Shërbimeve Publike kryesisht janë në mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore dhe ndricimin e rrugëve si edhe në shpenzime operative për mirëmbajtjen e parqeve ekzistuese. Perjashtim përben Bashkia Tiranë e cila ka në prioritetin e saj ndertimin e disa qendrave rekreative të cilat do të jenë për vitet në vijim dhe që janë në proces si

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Bulevardi i Ri i Tiranës, Parku Orbital si edhe rehabilitimin dhe ndertimin e terreneve sportive brenda lagjeve të ndryshme për të krijuar një Tiranë policentrike.

Gjithashtu në programin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë fondet për hapësirat publike për të rinjtë janë në nivelin e shpenzimeve operative, shpenzime për paga të personleve të ambientëve ekzistuese të bibliotekave, Qendrave Kulturore, Klubeve Shumësportesh, si edhe në paga për sportistët profesionist. Në secilën nga njesitë e qeverisjes vendore mungojnë fondet për përmirësimin e situatës lidhur me mungesën e mjedisëve publike për të rinjtë. E vetmja menyrë për ndertimin e hapësirave publike për të rinjtë është nëpërmjet aplikimit me projekte pranë Fondit për Zhvillimin e Rajonëve sepse në PBA 2017-2019 nuk ka fonde të parashikuara. Gjithashtu mungojnë fondet për investim në mjedisët e artit dhe hapësirat që mund të aksesohen nga të rinjtë por që kanë një përdorim më të gjerë dhe janë të destinuara për publikun e gjerë. Kjo situatë në mbështetje financiare shkon në një qasje të kundert me retoriken dhe premtimet persa i perket hapësirave për të rinjtë, ndertimin e parqeve polifunksionale apo ambientëve ku të rinjtë mund të mblidhen për tu organizuar apo për të shprehur talentin e tyre.

Përfundime dhe rekomandime

Hapja e një qendre rinore publike ku të bashkojë të rinjtë në iniciativat dhe për të shprehur talentin e tyre si edhe kalimi në menaxhimin e të rinjëve në qendrat egzistuese. Modelet e ngritura nga sipërmarrja private janë një shembull suksesi mirëfunksionimi si një qendër rinore dhe si një biznes social cfarë siguron një autonomi në funksionimin e qendrës. Mirëpo ka ende punë për të bërë në zbatimin e objektivave të parashikuar nga Plani Kombëtar i Veprimit, ku për hapjen e qendrave rinore multifunksionale është parashikuar edhe buxheti i plotë në total. Mungesë në nivel lokal shohim në krijimin e terreneve sportive për të rinjtë në lagje apo njesi administrative, si dhe shtimin e parqeve publike për të rinjtë (hapesire e gjelbert, terrene sportive). Gjithashtu duhen parashikuar fonde shtesë për ,irëmbajtjen dhe pajisjen me botime bashkëkohore për bibliotekat e qyteteve.

IV. Siguria Sociale

Vizioni dhe planifikimi në makro

Siguria social është një fushë e gjerë e cila përfshin nga nevojat bazike deri tek elementë specifikë që ndryshojnë nga njeri individ tek tjetri. Ajo ndryshon në kuptimin apo përberjen e saj me ndryshimin e ritmit të urbanizimit si edhe me zhvillimin teknologjik. Mbrojtja sociale ka qënë pjesë e rendësishme e secilës qeveri përgjatë viteve dhe ka qënë një pjesë e rendësishme e tyre. Megjithë përmirësimet e vazhdueshme ndër vite, në Shqipëri nuk ekziston një sistem i plotë që të sigurojë mbrojtjen sociale të të rinjve. Si rezultat fëmijët dhe të rinjtë, shpesh janë pre dhe vuajnë dhunën, shfrytëzimin, abuzimin, neglizhimin dhe përjashtimin social. Ndërkohë që strukturat e mbrojtjes ekzistuese janë të kufizuara, edhe mekanizmat për identifikimin, vlerësimin, referimin dhe sigurimin e shërbimeve të përshtatshme janë të kufizuara për të mos thënë që nuk ekzistojnë, Plani Kombëtar i Veprimit parashikonte një sërë masash që duheshin ndërmarrë mbi forcimin e kapaciteve deri tek përgjigjja komunitare.⁸ Një sërë reformash janë ndërmarrë në në sektorë të ndryshëm, duke e konsideruar mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe të rinjve si një çështje prioritare, të cilat përbëjnë boshtin kryesor të krijimit të sistemit kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve dhe familjes. Ndër pikat kryesore të parashikuara në planifikimet makro mbi këtë çështje janë parandalimi i dhunës dhe trafikimit të fëmijëve dhe të rinjve, objektiv i cili do të arrihet përmes edukimit në vazhdim dhe përmirësimit të kurrikulave ekzistuese në sistemin shkollor, fuqizimin e grupeve dhe organizatave rinore dhe deri tek fushatat ndërgjegjësuere të cilat do të nxisin reagimin qytetar për të denoncuar rastet e dhunës/trafikimit dhe mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe të rinjve. Një risi në këtë plan ishte dhe sigurimi i mbrojtjes sociale të të rinjve përmes politikave mbështetëse të strehimit, ku shteti mendohej të ishte negociatori dhe garantuesi me bankat e nivelit të dytë për të siguruar kredi zbutura për strehimin e çifteve të reja. Krijimi i shërbimeve komunitare është një tjetër objektiv specifik i këtij plani, shërbime të cilat synohen të jenë të qëndrueshme dhe të ofrojnë shërbime për grupet vulnerable dhe ato vështirë për tu arritur. Plani kombëtar ekzistues merr gjithashtu në konsideratë dhe nevojat e të rinjve që janë të rrezikuar apo mund të jenë të prekur nga fenomene të tilla si HIV/AIDS, përdorim droge, varësia ndaj lojërave të fatit, e të tjera.


⁸ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020

Analiza Ekonomike, Sociale e Politike në nivel lokal

Mbrojtja sociale ka një peshë jo të vogël në shpenzimet qeveritare të cilat janë të ndara në shpenzime për transferta korrente për njesitë e qeverisjes vendore, në transferta për buxhetet e individëve dhe familjeve si edhe për shpenzime për investime kapitale. Mbrojtja sociale është pjesë e Ministrisë së Shendetësisë dhe Kujdesit Social dhe zërin e saj në buxhet që për vitin 2017 ka patur shifrën e 141 miliardë lekë por për vec zërit për Mbrojtjen Sociale qeveria ka në strukturën e saj të shpenzimeve dhe fondin për Strehim dhe Banesa Sociale që për vitin 2017 ishte në vlerën e 29.433 miliardë lekë. Por edhe pse ka një zë të vecantë në buxhet nuk ka një specifikim për buxhetin në aspektin e sigurisë sociale për të rinjtë.

Sherbimi social në nivel lokal është në një specifikë me të vecantë edhe është i ndalur në mbeshtetjen e familjeve në nevojë, asistencat sociale si edhe qendrat e shërbimeve sociale. Sherbimet sociale në nivel lokal më tepër ngelën në kuadrin e projekteve specifike dhe jo në struktura të mirëfillta institucionale ku punonjësit e shërbimit social të kenë një rendësi dhe peshë të caktuar. Fondet në nivel lokal ndryshojnë nga njëri qytet në tjetrin përse i perket mbrojtjes sociale si edhe fokusi i shpërndarjes së tyre. Peshën më të madhe të fondeve për mbrojtjen sociale vjen nga transferta e kushtëzuar nga qeveria qendore e cila është e destinuar për asistencat sociale dhe pagesat për familjet në vështirësi ekonomike. Investimet kapitale për mbrojtjen sociale është në nivel të ulët dhe kryesisht në disa njesi vendore kanë shkuar për ngritjen e qendrave sociale për moshën e tretë si edhe për personat me aftësi të kufizuara. Në grafikun 5 janë të paraqitura fondet për mbrojtjen sociale duke përjashtuar transfertën e kushtëzuar e cila alokohet nga qeveria qendore kundrejt njesive të qeverive vendore.

Figura 5. Shpenzimet për Programin e Mbrojtjes Sociale nga njesitë e qeverisjes vendore për vitin 2017-2019 (në mijë lekë).



Burimi: Përpunim i autorit

Sic shikohet nga grafiku nivelin me të lartë të fondeve për Programin e Mbrojtjes Sociale e ka Bashkia Korçë me një fond prej 696.265 milionë lekë e cila ngelët pothuaj në të njëjtin nivel edhe për parashikimet për vitin 2018, 2019. Gjithashtu Bashkia Tiranë ka një fond të lartë me një vlerë prej 317 milionë lekë e cila deri në vitin 2019 do të arrijë vlerën e 409 milionë lekë. Fond i cili është i destinuar për ngritjen e qendrave komunitare dhe aktivitetet me karakter social por që të rinjtë nuk kanë një fond specifik duke qënë se edhe specifikat edhe problematikat e tyre janë të ndryshme nga grupmoshat e tjera. Nivelin më të ulët për vitin 2017 të fondit për Programin e Mbrojtjes Sociale e ka Bashkia Kukes me vlerën e 2.8 milionë lekë shpenzime për paga për personelin e shërbimit social por për vitin 2018 dhe vitin 2019 ky fond është parashikuar të rritet në vlerën e 166.56 milionë lekë. Ajo që vihet re në buxhetët lokale nuk ka zgjerim të fondeve për shërbimin social ku të ketë një modernizim të këtij shërbimi dhe rritjen e prezencës së shërbimit social në njesitë administrative. Fondet për sigurinë sociale në nivel lokal kryesisht peshën me të madhe shkojnë për banesat sociale dhe strehim si edhe pagesat e asistencave sociale por ka nevojë për një ristrukturim të fondeve në mënyrë që përfituesit nga shërbimi social të jëtë sa më i lartë.

Përfundime dhe rekomandime

Një ndër elementët më të rëndësishëm për përmirësimin e këtij segmenti është marrja në konsideratë e aftësimi i stafit pedagogjik, social dhe shëndetësor për të parandaluar dhe adresuar problemet e rasteve të dhunës, trafikimit të qenieve njerëzore (PSV), prostitucionin, në mjediset arsimore dhe më gjerë. Ky lloj ndiimi do kishte karakterin lokal të trajtesës së problemit dhe sigurisht që impakti do ishte imediat dhe i shpërndar sipas nevojave specifikeve të zonave të ndryshme. Forcimi kapaciteteve të OJF-ve, grupeve rinore dhe komunitetit në përgjithësi mbi parandalimin dhe referimin e hershëm të dhunës dhe trafikimit është një tjetër aspekt që do siguronte denoncimin e rasteve të dhunës dhe familjes dhe trajrimin me dinjitet të rasteve të tilla. Fushata sensibilizuese për edukimin e publikut mbi dhunën dhe trafikimin, me fokus të veçantë të rinjtë, vajzat dhe gratë e reja në zonat rurale duhet të jenë përgjegjësi e institucioneve locale, praktikisht e drejtorive që mbulojnë temën në fjalë. Përpos invetimeve të shumta të bëra kruesisht tre vitet e fundit, ndihet mungesa e ‘punonjësit social’ si një institucion më vete që duhet të gëzojë të gjitha modalitete e nevojshme për të operuar në terren.

V. Integrimi në BE

Mundësi për asistencë dhe potencial, makro

Procesi i integrimit shpesh është shikuar si një proces i politikës ku ecuria dhe përparimi është i lidhur me punën apo vullnetin e palëve. Por procesi i integrimit në Shqipëri është një proces që ka nevojë për përfshirjen më aktive të çdo aktori duke dhënë kontributin e tij. Ecuria me fazat e integrimit në BE i jep Shqipërisë akses dhe mundësi përfitimi në shumë programe që lidhen me zhvillimin e sektoreve të vecantë.

Shqipëria në stadin actual të integrimit mund të aplikojë për të marrë fonde në mekanizmat financiarë të Bashkimit Europian :

Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit (IPA)

IPA përfaqëson një mekanizëm financiar që ndihmon zbatimin e një serë aktiviteteve dhe nismash në vendet me perspektivi antarësimin në BE. IPA ndihmon në forcimin e institucioneve demokratike dhe zbatimin e ligjit, në promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, në mbështjen dhe zhvillimin e shoqërisë civile, barazisë gjinore, në nxitjen e bashkëpunimit rajonal, në zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe kontribuon në reduktimin e varferisë. Kjo asistencë ofron për qytetarët e shteteve aderuese mundësi më të mira për arritjen e standardeve të barabarta, sikurse ato që gëzojnë qytetarët e BE-së. Deri më sot ‘Programet e Bashkëpunimit Territorial’, në kuadër të fondet IPA, kanë njohur dy perspektiva financiare: IPA I (2007 - 2013), zbatimi i së cilës është në proces përfundimi, si dhe IPA II (2014 - 2020). Programet e Unionin Që prej nisjes së zbatimit të IPA I, Shqipëria ka siguruar mundësinë për të përfituar gjithashtu bashkë-financime nga disa prej programeve të tjera Bashkimit Evropian. Në ciklin 2007-2013, Shqipëria ka marrë pjesë në mënyrë aktive në 7 nga Programe të BE-së, të njohura si “Programet e Komunitetit” si edhe në kuadër të mekanizmit IPA II, gjatë viteve 2014-2020 Shqipëria do të përfitojë nga BE-ja gjithsej rreth 640 milion € asistencë. Programet për 2014-2020 ku Shqipëria merr pjesë janë:

- 1. Horizon 2020-**‘Horizon 2020’ është program i ri, i cili ofron një gamë të gjerë mundësish si për studiuesit e BE-së dhe ata shqiptarë, me synim nxitjen e bashkëpunimit midis aktorëve më të mirë ndërkombëtarë. Pjesëmarrja e Shqipërisë në

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

‘Horizon 2020’ do të ndihmojë vendin në forcimin e infrastrukturës shkencore, cilësinë e hulumtimit dhe nxitjen e inovacionin, duke kontribuar kështu në integrimin e mëtejshëm të vendit në Hapësirën Evropiane të Kërkimit.

2. **COSME** -Programi ‘COSME’ synon nxitjen e konkurrencës midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ai mbështet sipërmarrësit nëpërmjet edukimit mbi sipërmarrjen, mentorim, si dhe duke ofruar udhëzime dhe shërbime të tjera mbështetëse. Ndërhyrjet mbështesin grupe të veçanta, të cilat mund të kenë vështirësi në arritjen e potencialit të tyre të plotë, si p.sh. të rinjtë, gratë dhe sipërmarrësit e moshuar. Programi gjithashtu synon të ndihmojë bizneset në kuadër të mundësive të ofruara nga teknologjia digjitale.
3. **Erasmus +** ‘Erasmus +’ është programi më i ri arsimor i Bashkimit Evropian, i cili ka për qëllim rritjen e aftësive dhe punësimit, si dhe modernizimin e arsimit, trajnimit dhe punës së të rinjve. ‘Erasmus +’ përmbledh, nën një ombrellë të vetme, shtatë programet arsimore ekzistuese të BE-së, duke lehtësuar kështu orientimin e përfituesve dhe të rregullave të pjesëmarrjes. Si një programi i integruar, ‘Erasmus +’ ofron më shumë mundësi për bashkëpunim mes sektorëve të arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit. Ky program ka një qasje më të lehtë sesa paraardhësit e tij dhe aplikon rregulla më të thjeshtuara të financimit.
4. **Evropa Krijuese-Programi ‘Evropa Krijuese’** ka për qëllim mbështetjen e sektorit kulturor, audio-viziv, dhe krijues në nivel evropian. Ky program ndahet në 2 nën-programe: Nën-programi “Kultura” dhe Nën-programi “Media”.
5. **Europe for Citizens – Evropa për Qytetarët** - synon të nxisë bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve dhe organizatave nga vende të ndryshme, të lehtësojë zhvillimin e ndjenjës së përkatësisë në idealet e përbashkëta evropiane si dhe të nxisë procesin e integritimit evropian. Programi ka për qëllim të adresojë nevojën për të pasur debate më të mirëfillta në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar mbi çështjet e BE-së duke u dhënë mundësi qytetarëve për të bashkëvepruar dhe për të marrë pjesë në ndërtimin e një Evrope të afërt për të gjithë
6. **Customs 2020 – Programi ‘Doganat 2020’**, do të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve doganore në BE me qëllim për të ndihmuar në maksimizimin e efikasitetit të tyre dhe për të shmangur mospërputhjet në punën e tyre, të cilat mund të pengojnë mirëfunksionimin e Bashkimit Doganor.
7. **Fiscalis 2020**-Më 29 gusht 2012 Komisioni Evropian miratoi propozimin për programin ‘Fiscalis 2020’. Ky program synon të mundësojë që administratat tatimore

në shtetet anëtare të jenë plotësisht kompetente për të përmbushur sfidat e ardhshme në fushën e shmangies së mashtrimit me taksat dhe mbledhjen e të ardhurave për buxhetet e shteteve anëtare të BE-së.


8. **Programi për ‘Punësimin dhe Inovacionin Social’** -Programi për ‘Punësim dhe Inovacion Social’ mbështet nismat dhe strategjitë e qeverive për modernizimin e tregjeve të punës, sistemit të sigurimeve shoqërore dhe rritjen e normave të punësimit, në mënyrë të veçantë midis të rinjve. Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet krijimit të vendeve të punës, promovimit të një fuqie punëtore më të aftë, inkurajimit të përshtatjes ndaj ndryshimeve, si dhe duke përmirësuar qarkullimin gjeografik dhe duke promovuar inovacionin shoqëror.

- **Instrumenti i Ndhmës për Shoqërinë Civile (Civil Society Facility ose CSF)** për të ndihmuar financiarisht zhvillimin e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) në vëndet e para aderimit, të cilat kanë një rol vendimtar në dhënien e një zëri të përbashkët për qytetarët dhe në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së qeverisë. Objektivi i përgjithshëm i INShC është "Të kontribuojë në ankorimin e vlerave dhe strukturave demokratike, të drejtat e njeriut, përfshirjes sociale dhe shtetin e së drejtës, duke mbështetur procesin e integritimit në BE." IPA CSF është një strukturë e vetme e cila menaxhohet drejtpërdrejt nga Zyrat dhe Delegacionet e BE-së të vendeve përfituese.

Instrumenti i BE-së për Integrimin (EU Integration Facility) është pjesë e programit të veprimit IPA 2014, komponent i Integritimit në BE. Ky instrument synon të mbështesë administratën shqiptare në zbatimin e reformave në lidhje me Acquis të BE-së, të rrisë dialogun me Shoqërinë Civile në procesin e aderimit të Shqipërisë në BE dhe të forcojë kapacitetet administrative për të koordinuar sektorët e reformave, si dhe për të lëvizur drejt qasjes sektoriale.

Përgjatë viteve Shqipëria ka qënë përfituese e shume fondeve në kuadër të programeve të Bashkimit European. Kosto totale e projekteve që janë të implementuara, në implementim apo të parashikuara në Shqipëria nga programet e BE-së si edhe donator të ndryshëm european arrijnë në shifrën e 208 miliardë lekë. Kjo shumë është e parashikuar të jetë për programe të ndryshme, në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare duke prekur zhvillimin lokal dhe rural , kujdesin social, strehimin, zhvillimin e turizimit, punësimin, arsimin profesional si edhe sektorin e administratës publike me reformimin e tij.

Figura 6. Investimet nga Programet dhe donatorë të BE në Shqipëri spër vitet 2015- 2019 (në mijë lekë)



Burimi : Përlllogaritje e autorit (PBA 2017-2019)

Sic shikohet nga grafiku vlera e investimeve sipas programeve ka ardhur duke u rritur nga viti në vit por përseri ka fonde që nuk janë përthithur si duhet nga Shqipëria. Vlera e investimeve për vitet 2016 dhe 2017 ka qënë në vlerën e 15.85 miliardë lekë dhe 18.645 miliardë lekë. Të parashikuara për vitin 2018 në kuadër të projekteve që janë në implemtin dhe atyre të kërkuara vlera e investimeve mund të arrijë në 22.323 miliardë lekë ndersa për vitin 2019 vlera e kërkuar është 25.738 miliardë lekë. Pas vitit 2019 janë parashikuar të investohen fonde me vlerë 61.162 miliardë lekë.

Ajo çfarë është venë re është mungesa e informacionit si edhe formimit për të aplikuar në keto fonde nga institucionet e qeverisjes lokale dhe organizatave lokale që aplikojnë në keto njesi qeverisesë vendore. Prandaj duhet një punë me e madhe lidhur me krijimin e mundësisë së informacionit që qytetaret të jenë përfitues direkt në procesin e integritit.

Përfundime dhe rekomandime

Lidhur me këtë çështje, nga përvoja jonë në 12 qarqet, rezulton se të rinjtë janë disi të informuar mbi progresin konkret të Shqipërisë, duke përmendur statusin zyrtar të vendit dhe pak detaje që kanë marrë nga mediat. Sensi i optimizimit të tyre që gërshetohet me një mungesë të theksuar të informacionit të detajuar mbi procesin në tërësi, të drejtat dhe detyrimet që lindin, si dhe parapërgaditje që duhet të beje si administrata, ashtu edhe shoqëria civile në kuadër të hapjes së negociatave. Megjithatë ndihet një energji pozitive rinore e cila duhet të marrë formë e të shndërrohet në veprime konkrete nëpërmjet përfshirjes dhe mbështetjes së tyre për reformat e vështira që shpesh i paraprijnë integritit, duke mos anashkaluar trajtesën locale të të gjithë procesit. Duhet të ketë projekte sistematike për të ruajtur mbështetjen pozitive të të rinjve, duke rritur informacionin mbi BE-në dhe ngjallur pritshmëri realiste nga përfshirja si vënd në këtë process. Të rinjtë duhen inkurajuar dhe mbështetur për të vepruar si grupe presioni pozitiv ndaj qeverisë duke kërkuar vazhdimësinë dhe transparencën e reformave të nevojshme për integrimin, por mbi të gjitha duhet të aftësohen e të ngrejne kapacitetet e tyre nëpërmjet vetë mekanizmave që BE ka vënë në dispozicion nëpërmjet startegjive dhe programve që prekin shoqërinë civile dhe për rrjedhojë specifikiisht edhe rininë.

Përmbyllje:

Ky studim mbi politikat rinore lokale dhe qendrore vjen në një periudhë e cila përkon me pesë vite ekzistencë të Kongresit Rinor Kombëtar si platformë diskutimi dhe vendimarrjeje për të rinjtë shqiptarë, një vit e gjysëm nga ndërtimi dhe firmosja e Rezolutës së Rinisë nga Kongresi Rinor Kombëtar dhe partnerët strategjik e politik, si dhe me mesin e kohëzgjatjes së Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë.

Konstatimet e mësipërme tregojnë një mungesë të theksuar të planifikimit lokal mbi zhvillimin e politikave rinore, e aq më pak në përputhje me prioritetet e vendosura apo caktuara nga institucionet relevante në konsultim me aktorë dhe subjekte rinore të shoqërisë civile e më gjërë. Mungesa e ndarjes së buxhetit specifikisht për objektivat strategjike si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal e bën më të vështirë të besuarin në realizimin e këtyre të fundit.

Aktivizmi rinor vazhdon të mbetet në stilin “ad hoc” dhe në vullnetin e mirë të aktorëve lokal e ndërkombëtar duke e orvatur dhe riorientuar fokusin e politikave dhe veprimtarive sipas interesave specifike, por jo domosdoshmërisht interesave thelbësor dhe të mirëfilltë të rinisë shqiptare.

Ka një nevojë emergjente për orientimin e institucioneve lokale dhe donatorëve drejt nevojave dhe interesave të të rinjve e gjithashtu një dialogim dhe një proces konsultativ gjithëpërfshirës para ndërtimit të një plani kombëtar të ri e një baze funksionimi në nivel lokal.

Sistemi dhe standartet duhet të jenë ekuivalente edhe pse do i shërbejnë specifikave sipas zonave. Vetëm në këtë mënyrë do arrijmë të përdorim qasjen krahasimore dhe t’i afrohem realizimit të objektivave të trumpetuara këtu e dhjetë vite më parë.

Falenderim për të gjitha organizatat, grupet dhe forumet rinore pjesë e rrjetit të Kongresit Rinor Kombëtar, përgjegjësit e institucioneve qendrore dhe lokale relevant për politikat rinore, partnerët ndërkombëtar, media, të cilët kontribuan dhe ndhuan në realizimin e këtij punimi.

ANEKS 1

Rasti i Kosovës në menaxhimin e politikave rinore në nivel lokal dhe qëndror

Kosova ka një popullsi në rritje ku dominojnë grup-moshat më të reja. Të rinjtë dhe të rejat në moshë më të re se 25 vjeç përfaqësojnë 49 përqind të popullsisë, ndërsa 19.1 përqind të të rinjve janë në moshën 15-24 vjeçare.

SKPVR, trajton qasje të integruar për pjesëmarrje shoqërore, ekonomike dhe politike të rinisë në shoqëri.⁹ Në veçanti në proceset vendimmarrëse, edukim formal dhe joformal në përputhje me nevojat e tregut të punës, për shërbime shëndetësore mike për të rinjtë, siguri më të madhe, punësim dhe aktivitete rekreative për të rinjtë.

Nga 200 të rinj të anketuar, rezulton se interesimi i tyre fokusohet në segmentin e edukimit formal dhe joformal; 75% e të rinjve të anketuar në këtë fushë janë deklaruar se prioriteti i tyre është mësimi formal, përderisa 25% e tyre janë deklaruar se edhe edukimi joformal ka një rol të rëndësishëm në formimin e tyre profesional. Prioriteti i dytë është punësimi; rreth 70% e të anketuarve janë përgjigjur se janë më shumë të interesuar për punësim, përderisa 50% e të rinjve kërkojnë që të kenë hapësirë më të madhe rreth stimulimit të të rinjve për të themeluar biznese, ndërkaq përkrahja ekskluzive thuhet se duhet të bëhet nga institucionet shtetërore për krijimin e lehtësirave lidhur me themelimin e bizneseve të reja.¹⁰

Parimet mbi të cilat mbështeten strategjia dhe plani i veprimit për rininë

Parimet e SKPVR, nënkuptojnë respektimin e të gjithë të rinjve dhe të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë në të gjitha sferat shoqërore, ekonomike, arsimore, fetare dhe kulturore me qëllim të bashkëpunimit ndërmjet të rinjve pa dallime etnike në të gjitha aktivitetet shtetërore në përputhje me parimet dhe vlerat evropiane për të drejtat e njeriut.

⁹ Ligji Nr. 03/ L-145 30 shtator 2009 Shpallur me dekretin Nr. DL-029-2009, datë 19.10.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës

¹⁰ MPMS, Raporti i performancës vjetore,06/2010;Ministria e Punëve të Brendshme,Plani strategjik 2007-2010;Ministria e shëndetësisë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-2014,Youth Volunteerism in Kosovo:an opportunity to learn ,UNDP, 2010,Pristina.

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

1. Parimi i ligjshmërisë Strategjia Kosovare dhe Plani i Veprimit për Rininë mbështeten në Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të rinisë, aktet nënligjore, dokumentet strategjike relevante të Qeverisë së Kosovës dhe në parimet universale për të drejtat e të rinjve.

2. Parimi i pjesëmarrjes Hartimi i Strategjisë, është realizuar përmes një sistemi të gjerë pjesëmarrjeje, që përfshinë institucionet qendrore, shoqërinë civile, organizatat jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, dhe partnerët ndërkombëtar. Pjesëmarrja e gjerë e grupeve të interesuara, përbën edhe një tipar dallues të kësaj strategjie. Ajo përbën një nga garancitë e suksesit të saj.

3. Parimi i trajtimit të barabartë Përfshinë mbështetjen e të rinjve pa marrë parasysh etninë, gjininë, përkatësinë sociale dhe duke respektuar në veçanti përkrahjen e të rinjve me nevoja të veçanta dhe të rinjve të marginalizuar.

4. Parimi i qasjes së përbashkët, ndarjes së përvojave dhe përgjegjësiive Çështjet që i preokupojnë të rinjtë janë çështje ndër-sektoriale që janë para së gjithash përgjegjësi dhe obligim i ministrive të linjës dhe qeverisjes lokale, prandaj është i domosdoshëm shkëmbimi i informatave, përvojave dhe resurseve me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara në këtë dokument strategjik.

5. Parimi për të drejtën e informimit Parimi i të drejtës së informimit nënkupton të drejtën për informim të të rinjve si dhe qasjen në informacione në të gjitha sferat e interesit të tyre institucional.

6. Parimi i hartimit të strategjisë bazuar në dëshmi Çështjet rinore ndryshojnë vazhdimisht, varësisht nga trendi aktual dhe nevojat e të rinjve. Kjo strategji synon të mbështes zbatimin e objektivave të parapara dhe të përkrahë hulumtimet e vazhdueshme që identifikojnë nevojat e të rinjve dhe mundësojnë zhvillimin e politikave rinore të mbështetura në të dhëna konkrete.

7. Parimi i qëndrueshmërisë Strategjia është konceptuar si një platformë synimesh që nxit një pjesëmarrje aktive të grupeve të interesuara në zbatimin e saj. Departamenti i Rinisë (DiR), si përgjegjës kryesor në bashkëpunim me partnerët do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e strategjisë. Departamenti i Rinisë (DiR), gjatë hartimit të strategjisë ka treguar kujdes të shtuar për objektivat strategjike dhe objektivat specifike, që të jenë të përcaktuara, të matshme dhe të realizueshme.¹¹

¹¹ Fuqizimi dhe Zhvillimi i Strukturave Rinore në Kosovë Raport i Studimit themelor GIZ-EDYK, SUM Consult GmbH

Fotografimi i situatës në nivel lokal dhe qëndror:

1. Pjesëmarrja e të rinjve në proceset politkëbërëse:

Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë Nr. 03/L-145, “ka për qëllim avancimin dhe riafirmimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes, pa kurrfarë dallimi dhe përjashtimi, në zhvillimin e një shoqërie demokratike, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre shoqëror.” Gjithashtu, ky ligj obligon institucionet e Kosovës që të sigurojnë pjesëmarrjen e të rinjve dhe të sigurojnë gjithashtu ndikimin e duhur në procese të rëndësishme vendimmarrëse për të rinjtë. Për më tepër, ky ligj, detajon edhe disa prej fushave ku pjesëmarrja e të rinjve është e obligueshme si në: arsim; punësim; shëndet publik; çështje sociale; kulturë, sport dhe rekreacion; edukim qytetar dhe demokraci; ambient, planifikim hapësinor dhe zhvillim rural.

Të gjitha publikimet, raportet dhe hulumtimet e ndryshme në fushën e rinisë tregojnë se pjesëmarrja e të rinjve dhe ndikimi i tyre në shumë fusha të rëndësishme për jetën e të rinjve është simbolik dhe kjo për dy arsye: në njërin anë mundësitë e kufizuara të institucioneve publike që të përfshijnë në këto procese të rinjtë, dhe në anën tjetër kapacitetet e pamjaftueshme të të rinjve dhe organizatave të tyre rinore që të jenë pjesë e këtyre proceseve¹².

Sipas hulumtimeve dhe raporteve të ndryshme në sektorin e rinisë, në 34 komuna janë identifikuar 88 OJQ të sektorit të rinisë. OJQ-të rinore janë partner me rëndësi për sektorin e rinisë dhe zakonisht punojnë ngushtë me zyrtarët komunal për rini dhe janë të përfshira në formulimin e planit komunal për veprim rinor. Në shumë komuna, DKRS drejton aktivitetet e rinisë në komunë përmes këtyre OJQ-ve. Në përgjithësi, 88 OJQ-të rinore përbëhen prej rreth 450 anëtarëve; 61% prej tyre janë meshkuj dhe 39% janë femra. Ata zakonisht janë profesionistë të kualifikuar me diplomë universiteti (59%) ose kanë të përfunduar shkollimin e mesëm (39%).

Gjithashtu ekziston një rrjet i qendrave të rinisë të shpërndara nëpër komuna të ndryshme.

¹² MPMS, Raporti i performancës vjetore, 06/2010; Ministria e Punëve të Brendshme, Plani strategjik 2007-2010; Ministria e Shëndetësisë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-2014, Youth Volunteerism in Kosovo: an opportunity to learn, UNDP, 2010, Pristina.

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Qëllimi i qendrave rinore, është të sigurojnë një hapësirë për të rinjtë që ata të takohen dhe të shoqërohen, të ofrojnë aktivitete kulturore dhe sportive, mbështetje profesionale dhe të nivelit të njëjtë për çështje shëndetësore dhe psiko-sociale, si dhe trajnime relevante. Gjatë hulumtimit janë regjistruar 19 qendra të rinisë në 17 komuna (51% e komunave). Këto qendra të rinisë tani veprojnë si OJQ. Procesi i hapjes së qendrave rinore në të gjitha komunat do vazhdon, me përkrahjen e DiR, DKRS dhe donatorëve ndërkombëtar.¹³

Për më tepër, në hulumtimet e kryera rezulton se Këshillat e Veprimit Rinor Lokal (KVRL) janë të konsoliduara, të cilat konsiderohen të jenë pjesë e shoqërisë civile. Ekzistojnë 33 KVRL, që do të thotë 89% prej 37 komunave, sipas rezultateve nga studimi. Siç shihet, katër komuna nuk kanë KVRL dhe kryesisht këto janë komuna të reja, më të vogla, ose komuna me përqindje të madhe të popullsisë serbe, por janë në themelime të sipër.

Në përgjithësi, KVRL të cilat janë regjistruar gjatë studimit, përbëhen prej 250 anëtarëve; prej tyre 38% janë femra të reja dhe 62% janë meshkuj.

Më shumë se gjysma e tyre janë të moshës prej 19 deri 25 vjeç. Rreth 1/4 e anëtarëve të KVRL janë nën moshën 19 vjeç, që tregon për një përkushtim të madh nxënësve për çështjet e rinisë në nivel lokal.

Zhvillimet aktuale, si politike, socio-ekonomike, kulturore, imigrimi dhe emigrimi, varfëria e zhvillime të tjera, ndikojnë direkt në nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve, bazuar në analizat e dalta nga hulumtime të ndryshme. Organizimi i të rinjve nuk është madje i kënaqshëm as në shkollat, universitetet publike dhe kolegjet private, aty ku më së shumti pritet vetë-organizimi i të rinjve dhe ushtrimi i ndikimit të tyre në jetën mësimore, kulturore apo edhe të lidërshiptit në kuadër të këtyre institucioneve.

2. Edukimi joformal:

Fusha e edukimit jo-formal në shoqërinë tonë në përgjithësi gjatë zhvillimit është ballafaquar

¹³ Po aty

me probleme të shumta. Shumica e të rinjve si rrugë të vetme të avancimit në karrierë shohin edukimin formal pasi që kjo ide është krijuar në bazë të mungesës së ofrimit adekuat të edukimit jo-formal.

Nga rezultatet e hulumtimit, me grup-moshat 15-24 vjeç, të cilin e ka realizuar sektori për edukim jo-formal në kuadër të Departamentit të Rinisë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2012, mbi njohuritë për edukimin jo formal, rezulton se nga 100 të rinj të anketuar, 68 % e tyre nuk janë të informuar mbi edukimin jo-formal dhe rëndësinë e tij në ndërtimin e karrierës. Gjithashtu nga 100 të rinj të anketuar të cilët kanë përfituar nga edukimi jo-formal, rezulton se 72% e të rinjve kanë pasur probleme me njohjen e vlerave të marrura nga edukimi jo-formal.

Faktorë tjetër që ka ndikuar në mos zhvillimin e edukimit jo-formal, ka qenë mungesa e bashkëpunimit me palët e interesit për njohjen e edukimit jo-formal.

Andaj, duke bërë promovimin dhe nxitjen e të rinjve për vijueshmërinë në edukimin jo-formal dhe në të njëjtën kohë duke informuar të gjitha palët e interesit mbi rëndësinë e njohjes së edukimit jo-formal, do të krijohen kushtet për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve, njohjen dhe vlerësimin e edukimit jo-formal.

Një ndër elementet e rëndësishme që ndikon pozitivisht në edukimin jo-formal është edhe përfshirja e të rinjve në projekte inovative dhe kreative, ku ata përfshihen direkt në zbatim të projekteve, gjë që ka ndikim pozitiv në plotësimin e njohurive praktike që të rinjtë i përvetësojnë gjatë ciklit normal të edukimit.

3. Punësimi i të rinjve dhe Sipërmarja

Vlerësohet që në pesë vitet e ardhme përafërsisht 200,000 të rinj do të arrijnë moshën e punësimit dhe përafërsisht 110,000 prej tyre do të hyjnë në tregun e punës, ndërsa numri i personave që arrijnë moshën e pensionimit do të jetë përafërsisht 60,000 gjatë të njëjtës periudhë. Rritja e vazhdueshme neto në ofertën e fuqisë punëtore do të rrisë më tutje nevojën për të krijuar më shumë vende të punës¹⁴.

¹⁴ Strategjia Sektoriale 2009-2013, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Prishtinë,

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Në raportin e punës apo të performancës së Departamentit të Punës, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, 06/2010 dhe 06/2011, nënvizohet se moshë prej 15-24 vjeçare, e të rinjve të papunë, vazhdimisht përballlet me ngritjen më të madhe të shkallës së regjistrimit, afërsisht 1.8%, derisa grupet tjera të moshave janë më regressive.

Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e shkathtësive jetësore për të rinjtë që të përgatiten për tregun e punës varen nga sistemi arsimor i një vendi, prandaj edhe Kosova si një vend i ri nuk mund të largohet nga ky konstatim. Trajnimet për ngritjen e kapaciteteve profesionale për të rinjtë që të përgatiten për tregun e punës dhe aftësimi profesional, ndikon në ngritjen dhe shfrytëzimin më të mirë të mundshëm të burimeve njerëzore që shteti i Kosovës posedon.

Praktika në punë është një masë e tregut të punës që synon të ofrojë mundësinë e fitimit të përvojës së vlefshme në mjedisin e punës për pjesëmarrësit që kërkojnë të hulumtojnë apo fitojnë njohuri përkatëse dhe shkathtësi të kërkuara për të hyrë në fushën e caktuar të karrierës. Praktika në punë u ofrohet kryesisht personave të ri potencial që hyjnë në tregun e punës dhe personave të papunë.

Po ashtu, zhvillimi i biznesit rinor (sipërmarrjes) paraqet një rëndësi të veçantë si në drejtim të krijimit të vendeve të reja të punës ashtu edhe në drejtim të zhvillimit të ekonomisë në Kosovë. Nga ana tjetër, nxitja e krijimit të bizneseve të reja krijon premisa për forcimin e kapaciteteve të të rinjve dhe nxit pavarësinë e të rinjve karshi familjes dhe shtetit.

Në kushtet e sotme ekonomike, të rinjtë hasin vështirësi të shumta për të zhvilluar aktivitete ndërmarrëse. Mosnjohja e tregut të punës; mungesa e informacioneve për zhvillimin e rrethanave të tregut si ofertës dhe kërkesës në tregun e punës; edukimi jo i mirë në aspektin e sipërmarrjes; mosnjohja e bazës ligjore për t'u marrë me ndërmarrësi; mungesa e zhvillimit ideor për të ndërmarrë iniciativa për themelimin e biznesit; mungesa e besimit në vete dhe ambientit të ndërmarrësisë nëse mund të kenë sukses; mungesa e njohurive mbi kreditë dhe lehtësimet që ofrojnë bankat për biznese janë disa nga faktorët që konsiderohen si problematik. Nga kjo pikëpamje është veçanërisht e rëndësishme të ofrohet mbështetje për bizneset e reja në ndërmarrësi, mentorim dhe udhëzime për ndërmarrësit e rinj, si dhe promovim dhe zhvillim i kulturës së ndërmarrësisë.

4. Siguria njerëzore

Republika e Kosovës, përkundër përmirësimeve në fushën e sigurisë dhe parandalimit të krimit vazhdon të ballafaqohet me sfida të shumta. Treguesit e ulët socio- ekonomik, ilustrjnë kontradiktat zhvillimore të vendit, të cilat kanë gjeneruar jo vetëm probleme ekonomike dhe sociale, por edhe probleme të cilat lidhen me krimin dhe rreziqet që i' u kanosen të rinjve në fushën e sigurisë njerëzore në Kosovë.

Analiza e statistikave të krimit që ndërlidhet me sigurinë e bazuar në raportet e policisë së Kosovës, vë në pah një përmirësim të gjendjes së përgjithshme në fushën e sigurisë njerëzore, krahasuar me vitin 2008, ndërsa prej vitit 2009 deri në vitin 2011, kemi një rritje prej 2 % të numrit të veprave penale të raportuara në polici¹⁵.

Faktorët ekonomik, krimi i organizuar, kërcënimet dhe fatkeqësitë natyrore që janë pasojë e faktorit njeri, ndikojnë në sigurinë e të rinjve. Prandaj është i nevojshëm avancimi i vazhdueshëm i komponentës së sigurisë së të rinjve në Kosovë.

5. Integrimi Shoqëror, Vullnetarizmi, Sporti, Kultura dhe Rekreacioni

Integrimi shoqëror i të rinjve në SKPVR, gjithashtu, është promovuar përmes vullnetarizmit, sportit, kulturës dhe rekreacionit, duke bërë që të rinjtë kosovar të jenë pjesë aktive e shoqërisë dhe pranë proceseve zhvillimore.

Aktivitetet rinore rrisin kooperimin bazuar në diversitetin etnik dhe kulturor, që ndihmojnë në njoftimin e të rinjve për vlerat dhe pasuritë e përbashkëta kulturore të shoqërisë kosovare.

Departamenti Qëndror i Rinisë i vlerëson se aktivitetet vullnetare, sportive, kulture dhe rekreative, janë instrumente shumë të vlefshme në arritjen e qëllimit për integrimin e të rinjve në aspektin social. Promovimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit në Kosovë ka efekte të shumta pozitive, i cili iu mundëson të rinjve të fitojnë përvoja kuptimplota që mund të rrisë

¹⁵Policia e Kosovës

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

bashkëpunimin ndëretnik në mesin e të rinjve në të gjithë Kosovën, pastaj të lehtësojë bashkëpunimin më të mirë në mes të organizatave (joqeveritare, qeveritare, ndërkombëtare) në nivel lokal dhe qendror.

SKPVR ka një qasje proaktive në adresimin dhe promovimin e vullnetarizmit në mesin e të rinjve në Kosovë dhe është një ndër prioritetet për institucionet, OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare në nivel lokal dhe qendror.

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Referenca:

Analiza e Financave Vendore : <http://ëëë.financatvendore.al/>

“Analiza e vitit 2016 dhe plan buxheti për 2017-2018-2019”, Bashkia Berat

Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri 2000-2012, Eorl Bank Group, Qershor 2014

Fuqizimi dhe Zhvillimi i Strukturave Rinore në Kosovë Raport i Studimit themelor GIZ-EDYK, SUM Consult GmbH

“Lista e projekt ideve dhe planit lokal të veprimit 2017-2018”, Elbasan

Ligji në fushën e arsimit dhe formimit profesional: Ligji Nr. 8872, datë 29.03.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 10434, datë 23.06.2011, dhe me ligjin nr. 63, datë 26.06.2014 i jep rëndësi të veçantë këshillimit për punësim

“Lista e prioriteteve dhe investimeve sipas programeve të zhvillimit për të cilat kërkohen investime”, Bashkia Shkodër, 2015-2019

MPMS,Raporti i performancës vjetore, 06/2010; Ministria e Punëve të Brendshme,Plani strategjik 2007-2010;Ministria e shëndetësisë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-2014, Youth Volunteerism in Kosovo:an opportunity to learn ,UNDP, 2010, Prishtinë.

PBA 2017-2019 Shqipëri:

http://ëëë.financa.gov.al/files/userfiles/Buxheti/Programi_Buxhetor_Afatmesem_ne_Vite/PBA_2017-2019_Faza_III_Shkurt_2017.pdf

“Projekt Buxheti i PBA 2017-2019”, Bashkia Durrës

“Projekt Buxheti i PBA 2017-2019”, Bashkia Fier

“Projekt Buxheti i PBA 2017-2019”, Bashkia Lezhë

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

“Projekt Buxheti 2017-2019”, Bashkia Kukës

“Projekt Buxheti i PBA 2017-2019”, Bashkia Vlorë

“Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020”, Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë

“Plani Kombëtar i Aksionit për Punësimin e të Rinjve 2010- 2013”

“Policy and legislative framework for Youth participation in the Balkans – comparative overview and analysis”, ALDA European Association for Local Democracy, December 2015,

Raporti Progresi i Strategjise Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020, MPRShB
2016

Recommendations for creation Strategy on Youth, Administration for Youth and Sport,
UNDP, Civic alliance, March 2015,

“Relacion i buxhetit 2017”, Bashkia Fier

Research “The need for new services that foster youth employability and the role of youth
work”, NAPOR, June 2015

“Rinia dhe Sportet-plan lokal veprimi 2015-2019”, Bashkia Shkodër

“Rinia Shqiptare 2015...ndryshim i ngadaltë, mbështetje tek internet dhe besim tek BE!”
Fondacioni Friedrich Ebert, Tiranë, 2015

“Relacion i PBA 2017-2019”, Bashkia Tiranë

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2007-2013, Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë, Tiranë
2007

VËSHTRIM MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPERI

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe Plani i Veprimit miratuar me VKM Nr. 818, datë 26 nëntor 2014

Thematic Study on Policy Measures concerning Disadvantaged Youth, A. Ealther & A. Pohl, IRIS EV, Oct. 2005

Youth Employment Trends in Albania: What is the Market Looking For?, CDI & FES Tirana, 2015, <http://cdinstitutë.eu/ëeb/ëp-content/uploads/2016/05/t-150427-tëxt-engl.pdf>

“Youth in Albania: Challenges in changing times”, INSTAT, 2015